

## **URDHËR I BRENDSHËM**

**Nr. 7, datë 21.1.2025**

### **PËR DELEGIMIN E KRYERJES SË DETYRAVE QË KANË TË BËJNË MË PROCEDURAT E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve nr. 28, 29, të ligjit nr. 144/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 5, nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 26 dhe germës “i”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; të udhëzimit nr. 4, datë 18.6.2021, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, si dhe udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021, “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”,

#### **URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, kancelares, znj. Ardiana Krasniqi, për kryerjen e detyrave dhe nënshkrimin e akteve për të gjitha procedurat e prokurimit pranë kësaj gjykate.
2. Organi i deleguar nuk mund të nëndelegojë këtë kompetencë.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
4. Ngarkohet kancelarja, znj. Ardiana Krasniqi, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi sot, më datë 21.1.2025 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETAR I GJYKATËS**

**Lirim Bulica**